



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-036

Prishtinë, më 10 tetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 10 TETOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit,

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Ismet Hajrullahu,

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca,

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 tetor 2011,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 tetor 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 tetor 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet të premtën, më 14 tetor 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Forenzikës,
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Kërkesa e Institutit Demokratik të Kosovës për t'i monitoruar mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit

Kërkesa e cekur më lart u shty për mbledhjen tjetër të Kryesisë së Kuvendit.

3.2 Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me vizitën e realizuar në Parlamentin e Skocisë, nga data 19-23 shtator 2011

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të realizuar në Parlamentin e Skocisë, nga data 19-23 shtator 2011.

3.3 Harmonizimi i vendimeve për pagat, në bazë të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryesia diskutoi lidhur me harmonizimin e vendimeve për pagat dhe mori këtë:

V E N D I M

I. Vendimet aktuale për pagat, kompensimet dhe shtesat për deputetët e Kuvendit dhe stafin civil të Administratës së Kuvendit, nuk ndryshojnë për nga përmbajtja, por vetëm harmonizohen për vendimmarrje, sipas Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe Rregullores së Kuvendit:

1. Vendimi për nivelin e pagave,
2. Vendim për caktimin e lartësisë së kompensimit të deputetit për funksion udhëheqës dhe kompensimin e shpenzimeve mujore,
3. Vendimi për ndalesën e kompensimit të deputetit për mospjesëmarrje në seancë plenare dhe në mbledhje të komisioneve parlamentare.

3.4 Shënimi 10 - vjetorit të punës së Kuvendit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me shënimin e 10 - vjetorit të punës së Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

1. Kuvendi të mbajë Seancë solemne, më 10 dhjetor 2011, me rastin shënimit të 10-vjetorit të punës së tij.
2. Ngarkohet Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun që të përgatit materiale promovuese (albume me fotografi, publikime për punën e Kuvendit, fletëpalosje), një dokumentar njëorësh për historikun e Kuvendit të Kosovës, material video prezantues për punën e Kuvendit të Kosovës, ekspozitë fotografish të katër

legjislativave, si dhe konkursin për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme për Ede-në, me temën: Roli i Kuvendit të Kosovës në shoqërinë tonë.

3. Të organizohet koktej për përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, në hollin e Kuvendit.
4. Të formohet Grupi punues për organizimin e këtij manifestimi nga një përfaqësues prej: Kabinetit të Kryetarit, Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyrës së Protokollit dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë.
5. Shpenzimet e këtij manifestimi mbulohen në bashkëfinancim nga buxheti i Kuvendit dhe Misioni i OSBE-së.

3.5 Kërkesa e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës, për lejimin e kompensimit shtesë për anëtarët dhe stafin mbështetës të këtij komisioni

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

Kompensimi i punës së dy Komisioneve ad hoc: Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet, të bëhet në përputhje me nenin 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të Vendimit nr. 04-V-079, dt. 10 tetor 2011.

3.6 Formimi i grupeve të miqësisë

Kryesia, pasi diskutoi për grupet e miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe parlamenteve të shteteve të tjera, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Anëtarët e grupeve të miqësisë, të formuara nga legjislativa e mëparshme, e që nuk janë tani deputet të Kuvendit, duhet të zëvendësohen me deputetë të kësaj legjislature.
2. Kërkohet nga grupet parlamentare që t'i propozojnë anëtarët për formimin e grupeve të reja të miqësisë, me parlamentet e rajonit dhe me parlamentet e kontinenteve të tjera, me qëllim të zhvillimit të diplomacisë parlamentare.
3. Anëtarët e propozuar për grupet e miqësisë duhet të njohin gjuhën, kulturën dhe të kenë njohuri për ato vende, për të cilat formohen ato.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:55** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.